



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 14/11

Prishtinë, më 08.06.2011, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić, Latif Gashi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Hasime Krasniqi, Muhamet Mustafa, Duda Balje, dhe Xhevdet Neziraj.

Mungoi: Albana Fetoshi

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Agim Krasniqi nga MF, Skott Bowen nga AKP, Sokol Haziri dhe Daut Morina nga KNJ, Ekrem Hoxha nga AKP, Ismet Krasniqi nga Kuvendi i Kosovës, Ramadan Islami, Juergen Schatz, Teki Shala nga GIZ, monitorues nga KDI, OSBE.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Agjencisë Kosovare të Pronës;
I ftuar: Scott Bowen, Drejtor Ekzekutiv i AKP-së dhe Bedri Hamza, Ministër i Financave;
3. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Komisionit për Ndihmë Juridike, për vitin 2010
I ftuar: Sokol Haziri, Komisioner i Ndihmës Juridike;
4. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Autoritetit Rregullativ Telekomunikacionit për vitin 2010. I ftuar: Ekrem Hoxha, Kryetar i Bordit të ART-së;
5. Shqyrtimi i propozimit të Komisionit për përzgjedhjen e kryesuesit dhe anëtarit të Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës;
6. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Ndihmën Shtetëror;
7. Shqyrtimi i Raporti të shpenzimeve të Kuvendit për tre mujin e parë të vitit 2011
I ftuar: Ismet Krasniqi, Sekretar i Kuvendit;
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, hapi mbledhjen dhe propozoi rendin e ditës.

Rendi ditës miratohet pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Agjencisë Kosovare të Pronave

Scott Bowen, theksoi se nuk kemi kërkuar mjete shtesë dhe buxheti i AKP-së ka kaluar në Mars 2011. Kërkesa ka të bëjë me rritjen e koeficienteve për personelin vendor për 27%, në kuadër buxhetit aktual.

Agim Krasniqi, theksoi për zgjidhjen e problemit të këtij agjencioni dhe të gjitha agjencioneve tjera të pavarura duhet të përgatisin listën e pagave me koeficientet përkatës, pasi që pjesa që paguhet nga buxheti duhet të dihet saktësisht për çka po paguhet. Ministria nuk e mbështetë një kërkesë të tillë që nuk është analizuar në detaje.

Kryetarja, theksoi në kohën e aprovimit të buxhetit nuk ka pasur kërkesë detalizuese nga AKP-ja, në mënyrë që të analizohet se çka është planifikuar dhe çka po kërkohet, përveç një kërkesë që ka qenë për caktimin e buxhetit të dy anëtarëve të Bordit. Komisioni nuk ka bazë ligjore për të caktuar paga shtesë për asnjë agjencion, me përjashtim aty ku parashihet me ligj. Secili agjencion i ka punëtorët civil dhe rritja prej 30% sigurisht që është bërë edhe për personelin e këtij agjencioni. Kërkoj një detalizim të pagave, në mënyrë që të bazohen vendimet në dokumente konkrete ligjore.

Naser Osmani, propozoi që të mos merret vendim pa pasur informacione më të plota, si dhe po ashtu theksoi që është e nevojshme të dihet skema e pagave sipas kategorive me koeficient përkatës për të parë se a janë punëtorët e këtij agjencioni në kuadër të shërbyesve civil.

Sali Asllanaj, theksoi që ky është një problem i përgjithshëm për të gjitha agjencionet, të cilat objektivisht kanë një mospërputhje të pagesave me stafin civil në Kosovë. Për këtë nevojitet të bëhet një harmonizim i plotë i të gjitha pagave të shërbyesit civil, pa marrë parasysh se a është një agjencion i pavarur apo një agjencion shtetëror.

Scott Bowen, sqaroi se janë 72 punëtorë që paguhen nga buxheti i Kosovës që janë shërbyes civil dhe 170 punëtorë tjerë vendorë të cilët pagën bazë e marrin nga buxheti i Kosovës. AKP-ja është agjenci e përkohshme dhe kur të kryhet misioni i kësaj agjencie duhet të mbahen punëtorët dhe kjo është arsyeja që e kanë pagën bazë që u paguhet nga buxheti i Kosovës dhe pjesën tjetër që u paguhet nga donatorët. Lista që ju kërkon është dërguar në Ministrinë e Administratës Publike, por së shpejti do të dërgohet edhe në Komisionin për Buxhet dhe Financa.

Pas diskutimeve, komisioni nxorri këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. Agjencia Kosovare e Pronës të dorëzojë Komisionit për Buxhet dhe Financa, kërkesën e detalizuar dhe arsyetuar për rritjen e pagave për 27%, si dhe të dorëzojë listën e numrit të punëtorëve dhe pagave me koeficientet e tyre.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Komisionit për Ndihmë Juridike për vitin 2010

Kryetarja, kërkoi nga përfaqësuesit e KNJ-së kërkoi sqarim për lëvizjen e madhe të pagave brenda muajve. KNJ ka shpenzuar buxhetin 99.97% edhe për mallra dhe shërbime dhe në fund kanë tepruar vetëm 40,38 €, mirëpo nuk ka detalizim se si janë shpenzuar këto mjete.

Sokol Haziri, çështja e pagave ka variuar dhe tri pozicione në shërbimin civil janë miratuar nga Ministria përkatëse. KNJ është i vendosur në një objekt me qira dhe një pjesë e madhe e mjeteve shpenzohet në këtë drejtim, si dhe pagesat e avokatëve që janë në shërbim.

Daut Morina, sqaroi se ka pasur lëvizje në kategorinë e pagave, për shkak të dis-harmonizimit për pagesën e komisionit që përbëhet nga një komisioner dhe nëntë zëvendësues dhe prej momentit kur nga mallrat dhe shërbimet janë bartur mjetet në kategorinë e pagave në muajt e parë nuk është mundësuar të futen në sistem, sepse ka pasur një dis-harmonizim në mes sistemit të pagesave dhe thesarit.

Naser Osmani, theksoi e çështja e pagave është një pagesë mujore përafërsisht e pandryshuar, duke lejuar lëvizje të vogla. Por është e çuditshme se muaji Dhjetor dallon për dyfishin e pagesave në muajt e tjerë, a do të thotë kjo që janë shpërndarë të gjitha mjetet në mënyrë që të mos mbetet asnjë euro pa e shfrytëzuar, apo ka pasur obligime për muajt e papaguar me herët? Po ashtu e njëjta situatë e lëvizjeve të mëdha është edhe në kategorinë mallra dhe shërbim, përderisa në muajin Gusht ndodh shpenzimi më i madh në vlerë prej 40.000 € duke ditur që është muaji i pushimeve. Për këtë nevojitet një shpjegim shumë i detalizuar, për shkak se procedura e harxhimit është konfuze

Sali Asllanaj, pyeti se koeficientet a i cakton KNJ apo dikush tjetër?

Sokol Haziri, njoftoi se bordi merr honorar mujor në vlerë prej 300 €, për komisioner dhe 250 € për zëvendësuesit, ndërsa pjesa tjetër janë shërbyes civil. Bordi është kompenzuar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve deri sa janë futur në sistem të pagesave. Shkaku u varimit të shifrave ka të bëjë me pagat e avokatëve të angazhuar, pasi që faturat nuk vijnë për çdo muaj, sepse nuk dihet se si është agjenda e tyre.

Hasime Krasniqi, shprehu dyshimin lidhur me paraqitjen e shifrave në raportin vjetor financiar të KNJ, duke sugjeruar se do të kishte qenë më mirë që këtij raporti t'i bashkëngjiteshin sqarimet në mënyrë më analitike. U pajtua me parafolësin për shpenzimet prej 40.000 € që kanë ndodhur në muajin Gusht, gjë që duket e paarsyeshme. Nga raporti shihet se KNJ ka hyrë në obligim për vitin 2011, pasi që për pagesat e vitit 2011 ka mbetur obligimi prej 23.222 €. Ndoshta ka qenë e mundur që të kursehet nga mallrat dhe shërbimet dhe të kryhen këto obligime, në mënyrë që të mos mbesin për vitin 2011.

Hykmete Bajrami, përgjithësisht shprehu shqetësimet e njëjtë sikurse parafolësit e saj, për nevojën e dorëzimit të listës së pagave të punësuarve, se sa janë punëtorë që paguhën me paga fikse dhe sa janë me paga variabile. Për mallrat dhe shërbimet po ashtu nevojitet kategorizim lidhur me atë se për çka konkretisht janë shpenzuar mjetet si dhe rekomandoi që përderisa nuk sigurohen të gjitha këto sqarime, të mos kalohet ky raport financiar për miratim në Kuvend.

Pas diskutimeve dhe vërejtjeve, komisioni nxori këtë:

PËRFUNDIM

I. Kërkohet nga Komisioni për Ndihmë Juridike, të dorëzojë një raport të detализuar financiar, në bazë të së cilit, Komisioni do ta aprovojë apo jo raportin vjetor financiar të KNJ-së, për vitin 2010.

4. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit për vitin 2010

Kryetarja, theksoi që në raportin e përgjithshëm të ART-së pjesa financiare ka qenë shumë e mangët, mirëpo përmes stafit është kërkuar që të sillet një raport më i detализuar dhe ART-ja i është përgjigjur kësaj kërkesë. Kërkoi sqarime për shifrat e paraqitura në buxhetin final, si dhe për shpenzimet kapitale që është ndarë shuma në vlerë prej 875.000 €, ndërsa pagesa janë bërë vetëm 126.000 €.

Ekrem Hoxha, lidhur me shpenzimet kapitale sqaroi se ky realizim prej vetëm 17% është si rrjedhojë e dy zhvillimeve pasi që ART-ja ka qenë e kufizuar në iniciimin e projekteve të prokurimit nga mos ndarja e buxhetit prej 50% që ka qenë e premtuar nga Ministria e Financave, dhe kjo nuk është mosefikasitet menaxherial i ART-së por është rrjedhojë e dispozitave të Ligjit të Prokurimit. Kjo ka sjellë probleme buxhetore edhe për vitin 2011. Nga komisioni kërkoi që të mundësohet pavarësia financiare e ART-së, sepse me funksionimin aktual po paraqiten vështirësi edhe në planifikim edhe në realizim, duke mbetur peng i procedurave aktuale.

Kryetarja, theksoi që raporti në përgjithësi është i detализuar. Në raportin vjetor keni shkruar se Komisioni për Buxhet dhe Financa, nuk iu ka lejuar mjetet, e që në fakt ne si komisioni jemi përpjekur për agjencionet e pavarura që të kenë pavarësinë financiare, mirëpo kur janë ndarë mjetet është thënë që të shikohet arsyeshmëria dhe të shikohet se si po shkojnë procedurat në gjashtëmujorin e parë, në mënyrë që mjetet të merren në gjashtëmujorin e dytë.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. I rekomandohet Kuvendit të miratojë raportin vjetor financiar të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit për vitin 2010.

5. Shqyrtimi i propozimit të Komisionit për përzgjedhjen e kryesuesit dhe anëtarit të Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

Kryetarja, theksoi se pas kërkesës së Kuvendit, Qeveria ka sjellur opinionin e saj ku mbështet kandidatë e propozuar për bordin e TKPK. Nga CV-të e tyre shihet se i plotësojnë kushtet formalo-juridike për pozitën e propozuara dhe propozojë, që komisioni ti rekomandojë Kuvendit për miratimin e propozimit të Komisionit për përzgjedhje.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri, nxori këtë:

REKOMANDIM

1. I rekomandohet Kuvendit të miratojë propozimin e Komisionit për Përzgjedhje, për emërimin e z. Ejup Qerimi, anëtar të Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, në cilësinë e anëtarit për përfaqësimin e interesave të punëdhënësve, me mandat tre vjeçar,

dhe z. Ymer Havolli, kryesues të Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, me mandat deri më 30 prill 2012.

6. Shqyrtimi në parim i projektligjit për Ndihmë Shtetërore

Kryetarja, ka vërejtur që ky projektligj përmban implikime buxhetore, pasi që ka të bëjë me ndihmën shtetërore, të cilën mund ta japin edhe nivelet qendrore dhe ato lokale. Projektligji parasheh caktimin e një Komisioni për Ndihmë Shtetërore dhe një Zyrë që caktohet në kuadër të Komisionit të Konkurrencës, detyrat e së cilës nuk ishin edhe aq të detalizuara. Po ashtu nuk kishte sqarime për ndërlidhshmërinë në mes të Komisionit për Ndihmë Shtetërore dhe Zyrës për Ndihmë Shtetërore. Megjithatë pasiq që i njëjti përbush kushtet e përgjithshme për miratim në parim, propozojë që Komisioni, ti rekomandojë Kuvendit, miratimin e tij në parim, mëpastaj më detalisht do të merret komisioni.

Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I. I rekomandohet Kuvendit, të miratojë në parim Projektligjin për Ndihmën Shtetërore.

7. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve të Kuvendit për tremujorin e parë të vitin 2011

Ismet Krasniqi, theksoi që raporti është tregues i të gjitha shpenzimeve që kanë ndodhur në Kuvend gjatë tremujorit të parë të vitit 2011 duke i paraqitur me planifikime mujore. Pagesat për muajin Mars bëhen në muajin Prill, të cilat do të paraqiten në tremujorin e dytë të vitit.

Hasime Krasniqi, komplimentoi për përgatitjen e një raporti të detalizuar dhe të kuptueshëm. Rekomandoj që të kursehen shpenzimet që mund të kursehen.

Kryetarja, kërkoi sqarime për kategorinë akomodimi i punëtorëve dhe drekat zyrtare për çka janë shpenzuar?

Ismet Krasniqi, këto shpenzime janë bërë me rastin e hartimit të planit të Kuvendit.

Pas diskutimeve, Komisioni nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I. I rekomandohet Kryesisë së Kuvendit, të miratojë Raportin e Shpenzimeve të Kuvendit për tremujorin e parë të vitit 2011.

8. Të ndryshme

8.1. Njoftim për punën e grupit punues për Projektligjin për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim

Kryetarja, kërkoi informata për punën e grupit punues për Projektligjin për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, pasi që puna duhet të nxitohet për shkak se Kryetari i kuvendit kërkon një datë se kur mund të përfundohet puna nga komisioni.

Hykmete Bajrami, theksoi që jemi në kohë me Projektligjin dhe të gjitha komentet e të interesuarve në dëgjimin publik janë gati. Prej javës së ardhshme brenda dy-tri ditëve do të jetë gjithçka gati dhe komisionit do t'i paraqitet raporti me amendamente.

8.2 Caktimi i grupit punues për monitorimin e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal

Kryetarja, njoftoi se GIZ-i në bashkëpunim me stafin mbështetës, kanë përgatitur një plan veprimi për monitorimin e Ligjit për financat e pushtetit lokal. Propozoi që takimi i parë të jetë me Ministrin e Financave, i cili do të ftohet në mbledhjen e komisionit dhe të japë mendimin e përgjithshëm lidhur me implementimin e Ligjit, dhe pas kësaj do të fillojë puna për të parë se ku janë problemet. Takimi i dytë të jetë me Ministrinë e Financave për të marrë informata më të detalizuara dhe në fund të shkohet në takime me Kuvendet Komunale.

Pas propozimeve, u formua grupi punues për monitorimin e Ligjit, me këtë përbërje:

1. Safete Hadërgjonaj – kryesuese
2. Duda Balje
3. Jelena Bontić
4. Sali Asllanaj
5. Hasime Krasniqi

8.3 Caktimi i grupit punues për Projektligjin për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia ndaj palëve të treta

Pas propozimeve, u formua grupi punues, me këtë përbërje:

1. Sali Asllanaj - kryesues
2. Latif Gashi
3. Jelena Bontić

8.4 Caktimi i grupit punues për Projektligjin për Produktet e Akcizës së Duhanit

Pas propozimeve, u formua grupi punues, me këtë përbërje:

1. Naser Osmani-kryesues i grupit
2. Albana Fetoshi
3. Safete Hadërgjonaj

Mbledhja përfundoi në orën 12:30

Përqatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete HADËRGJONAJ